



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

## Komisioni Disiplinor

---



# Raport i Punës janar - qershor 2017

Prishtinë, 25 shtator 2017

## Komisioni Disiplinor

Komisioni Disiplinor është komision i përhershëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës i përcaktuar me nenin 5 paragrafi 1.4 të Ligji Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Me datë 05 nëntor 2015 Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar Rregulloren Nr.05/2015 për Punën e Komisionit Disiplinor dhe Procedurën Disiplinore ndaj Prokurorëve, me të cilën është përcaktuar organizimi dhe funksionimi i Komisionit Disiplinor si komision i përhershëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje KPK), si dhe procedurën disiplinore që zhvillohet ndaj prokurorëve.

Rregullorja do të përcaktoj rregullat e procedurës disiplinore që zhvillohen ndaj prokurorëve, të iniciuara nga Zyra e Prokurorit Disiplinor (tutje ZPD).

Në bazë të nenit 15 dhe nenit 5 të Ligjit nr.05/L - 035 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 11 shtator 2015, me vendimin KPK.nr.243/2015, ka themeluar Komisionin Disiplinor në këtë përbërje:

1. Idain Smailji, Kryesues
2. Sevdije Morina, anetare dhe
3. Sabri Ademi, anëtar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L - 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 05 tetor 2016 merr vendim që ta aprovoj kërkesën e prokurorit Idain Smailji, për tu liruar nga pozita e kryesuesit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të Rregullores Nr.05/2015 për Punën e Komisionit Disiplinor dhe Procedurën Disiplinore ndaj Prokurorëve, në takimin e mbajtur më datë 05 tetor 2016, merr vendim që anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokurori Arben Ismajli të zgjidhet kryesues i Komisionit Disiplinor.

Përbërja e tanishme e këtij komision është:

1. Arben Ismajli, Kryesues
2. Sevdije Morina, anetare dhe
3. Sabri Ademi, anëtar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr.05/2015 për Punën e Komisionit Disiplinor dhe Procedurën Disiplinore ndaj Prokurorëve, në takimin e mbajtur më datë 12 shkurt 2016 mori vendimin KPK.nr.51/2016, që të plotësohet vendimi KPK.nr.243/2015 me anëtarë rezervë të Komisionit Disiplinor me këtë përbërje:

1. Haxhi Sinanaj, zëvendëskryesues
2. Lulzim Sulejmani, anëtar dhe
3. Xhevdet Bislimi, anëtar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1.21, 1.26 dhe 1.27 dhe nenit 23 të ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me nr. 03/L - 224 të datës 30 shtator 2010, e në pajtim me nenin 5 paragrafi 5.2, nenin 6 paragrafi 6.1, nenit 7,8 dhe 9 të Rregullores së Komisionit Disiplinor të Këshillit Prokurorial të Kosovës Nr. 278/2011 të

datës 27 prill 2011, sipas propozimit të Komisionit Disiplinor të datës 19 korrik 2011 merr vendim që Lindita Memeti të emërohet për sekeretare e Komisionit Disiplinor të Këshillit Prokuroial të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 24 dhjetor 2014, ka marrë vendim që Lindita Memeti, Administratore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, të caktohet sërish sekretare e Komisionit Disiplinor Këshillit Prokurorial të Kosovës.

**Komisioni Disiplinor, si komision i përhershëm është përgjegjës që të:**

- Shqyrtojë të gjitha çështjet disiplinore ndaj prokurorëve të iniciuara nga ZPD-ja;
- Zhvillojë seanca disiplinore ndaj prokuroreve pas paraqitjes së raportit nga ZPD-ja;
- Shqipton masat disiplinore ndaj prokurorëve në KPK;
- Kryen detyra të tjera nga fushveprimi i tij me kërkesë të KPK-së.

**Lëndë të trashëguara nga vitet e kaluara në vitin 2017**

Në fillim të vitit 2017 janë trashëguar 8 raste disiplinore nga vitet e kaluara.

**Lëndë të pranuar për periudhën janar - qershor 2017**

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 4 raste disiplinore të iniciuara nga Zyra e Prokurorit Disiplinor

**Seanca të mbajtura në periudhën janar - qershor 2017**

Gjatë kësaj periudhe kohore janë 12 seanca disiplinore, nga të cilat janë trajtuar 10 raste disiplinore me vendime.

**Janë marrë këto vendime:**

7 Vendime - Pushim i procedurës disiplinore/

(5 për shkak se prokurori/ja nuk është më në sistemin prokurorial) dhe  
(2 për shkak të parashkrimit të procedurave disiplinore)

2 Refuzim i Kërkesës për suspendim/kanë dhënë dorëheqje nga detyra e prokurorit pasi që i është caktu shqyrtimi disiplinor.

1. Zvogëlim i përkohshëm i pagës në tridhjetë përqind (30%), për periudhën 3 (tre) mujore

**Gjatë periudhës janar - qershor 2017 janë pranuar këto ankesa**

1. KPK/KD/07/2016/ PTH Prishtinë ankesa e pranuar më 20 janar 2017
2. KPK/KD/03/2017 27/ PTH Prizren ankesa e pranuar më 27 qershor 2017

**Ankesa të shqyrtuara në KPK - 2017**

1. KPK/KD/07/2016/PTH Prishtinë 20 janar 2017 - Qortim me urdhër për ndërmarrje të veprimeve korigjuese 09 mars 2017